

Nr. _____ Prot.

Tirane, me 29. 09. 2016

Lënda: Miratimi i procedurës së punësimit të personelit akademik te ftuar për vitin akademik 2016 - 2017.

V E N D I M

Departamenti i Arkitekturës, në mbledhjen e datës 29. 09. 2016 vendosi:

Kriteret për pranim të personelit akademik të ftuar:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet e plota universitare brenda ose jashtë vendit. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të njohura nga MAS.
2. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet Master Shkencor (ekuivalente me të) në *profilin* Arkitekture, me notë mesatare mbi 7,5. Preferohet mesatarja e lëndëve të specialitetit mbi 9.
3. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj perëndimore e mbrojtur dhe e vërtetuar me dëshmi. (preferohen gjuhët anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht).
3. Preferohen kandidatet të zotërojë gradën DOKTOR ose te jete ne proces te mbrojtjes se Doktoraturës ne fushën e Arkitekturës (preferohen studentet e shkollës se Doktoraturës ne FAU).
4. Preferohen kandidatet që kanë kryer kurse. kualifikime etj, apo që kanë bërë publikime brenda ose jashtë vendit, në fushën e specialitetit përkatës .

Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatët për personelin akademik të ftuar:

1. Kërkesë te vecantë me shkrim për seicilen lëndë ku kërkon të konkurojë (jo më shume se pesë lëndë – kërkesat pa lëndë të specifikuara, nuk shqyrtohen nga komisioni).
2. Dokument identifikimi (kopje e noteruar).
3. C. V të përgjithshme të përqendruar.
4. Diploma dhe të lista e notave (kopje e noteruar).
5. Dëshmi te gjuhëve të huaja që zotëron.
6. Provime pasuniversitare, mikroteza etj.
7. Botime (monografi, artikuj, tekste mësimore, projekte).
8. Kualifikime brenda ose jashtë vendit.
9. Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore.
10. Raport mjeko-ligjor.
11. Dy letra referencash.

Shënim: Dorëzimi i dokumentacionit nga kandidatët, do të kryhet pranë sekretarisë së Departamentit te Arkitekturës, (FAU) deri ne datën 14.10.2016.

Vlerësimi i kandidatëve për personelin akademik të ftuar:

Komisioni i vlerësimit, përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë: përgjegjësi i departamentit, drejtuesi i lëndës, mesimdhënës lëndës (apo të lëndëve të ngjashme).

- Vlerësimi i përmbajtjes të dosjes së dorëzuar nga konkurenti (60 %)
- Vlerësimi i konkurentit nëpërmjet një interviste në komisionin e vlerësimit (40%)

Në përfundim të procesit, komisioni liston kandidatët në rend zbritës, dhe kjo listë shërben për plotësimin e vendeve vakante për mesimdhënie në lëndën përkatëse.

Lëndët ku konkurohet për personelin akademik të ftuar:

KURSI	DEGA	LENDË
VITI 1	A+U	Bazat e Grafikes + Modelimit
	+U	Bazat e Vizatimit
	A+U	Gjeometri Deskriptive 1
	A+U	Gjeometri Deskriptive 2
	A+U	Histori Arkitekture 1
	A+U	(Materiale)+Element ndertesash
	A+U	Bazat e Projektimit
VITI 2	A+U	Histori Arkitekture 2
	A+U	Histori Arkitekture 3
	A+U	Komp, Analize Forme/Hapsire
	A+U	Komp, Analize Forme/Hapsire
	A+U	Studio Arkitekture 1
	A+U	Studio Arkitekture 2
	ND	Arkitekture teknike - ndertim
VITI 3	A+U	Teknologji Arkitekture 3
	A+U	Studio Arkitekture 3
	A+U	Studio Arkitekture 4
	A+U	Teori Arkitekture/Urbanistike
	A+U	Fizike Ambjentale
	N+GJ	Histori Arkitekture (me zgjedhje)
VITI 4	A+U	Projektim Ambjental
	A+U	Projektim Ambjental
	A+U	Kerkim Shkencor + Etike Profesionale (I. m. zgj)
	A+U	CAAD-Vizualizim Grafik 2
	A	Studio Arkitekture 5
	A	Studio Arkitekture 6
	N	Grafike Inxhinierike dhe Projektim Arkitektonik (M)
VITI 5	A	Studio Arkitekture 7
	A	Arkitekture Interieri
	A	Adaptim Arkitektonik